

Nr. 2258
13.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 619/prot.

Gjirokastrë, më 09.7.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË
Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 48, datë 26.6.2026, “Për miratim të kërkesës për dhënie dakordësie për realizimin e ndërhyrjes së rehabilitimit të venddepozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë, pronë e Bashkisë Tepelenë”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’ nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 49, datë 26.6.2026, “Për miratim të Planit të Integritetit të Bashkisë Tepelenë 2026-2028”, konfirmohet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



PREFEKTI
Albana Hasanaj